



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. regjistri 3/2018 (JR)
Datë 17.04.2018

Nr. vendimi 2/2018
Datë 10.07.2018

**V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese, i përbërë nga:

Rezarta Schuetz	Kryesuese e Trupit Gjykses
Ardian Hajdari	Relator i Çështjes
Ina Rama	Gjyqtare
Luan Daci	Gjyqtar
Sokol Çomo	Gjyqtar,

monitoruar dhe mbikëqyrur nga Vëzhguesi Ndërkombëtar Ferdinando BUATIER DE MONGEOT, asistuar nga Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, në Tiranë, sot më datë 10.07.2018, ditë e martë, ora 11:00, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen nr. 3/2018 (JR), datë 17.04.2018, me të dhënat e mëposhtme –

Ankues: Komisioneri Publik, Florian Ballhysa
Subjekti i rivlerësimit: Sulejman Tola, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë
Objekti: Prishja e vendimit nr. 4, datë 23.03.2018, e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit
Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Neni C, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

– pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Ardian Hajdari dhe shqyrtoi shkresën nr. 9/4, datë 12.06.2018, në të cilën rezulton se Komisioneri Publik ka hequr dorë nga ankimi, konstatoi se ishin njoftuar rregullisht si Komisioneri Publik, edhe subjekti i rivlerësimit Sulejman Tola, për formën e gjykimit, si dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Në lidhje me çështjen

1.1 Më datë 17.04.2018, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit është regjistruar çështja me nr. 3/2018 (JR), bazuar në ankimin me nr. prot. 9/1, datë 13.04.2018, të ushtruar nga Komisioneri Publik, ndaj vendimit nr. 4, datë 23.03.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), dhënë për subjektin e rivlerësimit, z. Sulejman Tola, prokuror në Prokurorinë e Krujës, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.

1.2 Subjekti i rivlerësimit Sulejman Asllan Tola, i lindur më 19.02.1952, në Shijak, ka ushtruar detyrën e Prokurorit pa ndërprerje që nga viti 1979. Ky subjekt, duke u bazuar në nenin 56 të ligjit 84/2016, ka dhënë dorëheqjen nga detyra e Prokurorit, duke ia drejtuar kërkesën Presidentit të Republikës, z. Bujar Nishani, protokolluar nga Institucioni i Presidentit me nr. 8/S prot., datë 26.01.2017.

Përpara deklarimit të dorëheqjes, z. Tola ka qenë me detyrë Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë. Subjekti, në kërkesën për dorëheqje, referon datën 19 shkurt 2017 si datë të mbushjes së moshës për daljen në pension.

1.3 KPK-ja, në dhomë këshillimi, ka çmuar se afati 3-mujor i hyrjes në fuqi të ligjit 84/2016 mbaron më datë 31.03.2017, ndaj dorëheqjen e subjektit Sulejman Tola e ka konsideruar brenda afatit të parashikuar nga neni 56 i ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, më datë 23.03.2018, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Sulejman Tola, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, dhe me vendimin nr. 4, datë 23.03.2018, vendosi deklarimin e pushimit të procesit të rivlerësimit për subjektin Sulejman Tola.

Me këtë vendim janë njohur rregullisht subjekti i rivlerësimit Sulejman Tola, Komisioneri Publik dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

Në lidhje me procedurën

1.4 Kolegji i Posaçëm i Apelimit është vënë fillimisht në lëvizje me ankimin e Komisionerit Publik, datë 17.04.2018, kundër vendimit të datës 23.03.2018 të KPK-së për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit lidhur me z. Sulejman Tola. Në ankimin e tij me nr. prot. 9/1, datë 13.04.2018, Komisioneri Publik parashtron shkaqet kryesore, të cilat lidhen kryesisht me aspekte procedurale të zbatimit të dispozitave të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në harmoni me dispozitat e Kushtetutës dhe ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Më konkretisht:

1.5 Një ndër shkaqet që Komisioneri Publik parashtron në ankimin e tij, është krijimi i praktikave të ndryshme nga Komisioni, për raste të njëjta, për sa i takon verifikimit të zbatueshmërisë së dispozitave ligjore që rregullojnë aspektet procedurale të dorëheqjes së magjistratëve. Sipas Komisionerit Publik, dorëheqja nga subjektet e rivlerësimit duhet të materializohet dhe të

formalizohet nga organi kompetent kushtetues sipas ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në mënyrë që të japë pasojat juridike të kërkuara.

1.6 Shkak tjetër i parashtruar nëpërmjet ankimit nga Komisioneri Publik, është se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në vendimmarrjen e tij, nuk e pasqyron as në dispozitiv dhe as në arsyetim të vendimit pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, që e ndalon për 15 vite emërimin e subjektit të rivlerësimit në sistemin e drejtësisë.

1.7 Së fundmi, Komisioneri Publik në ankim parashtron se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit duhet të kishte disponuar edhe për subjektet e rivlerësimit që e japin dorëheqjen në seancë publike.

II

Në lidhje me kërkesën për heqjen dorë nga ankimi

2.1 Më datë 12.06.2018, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Komisioneri Publik depozitoi shkresën me nr. prot. 9/4, datë 12.06.2018, nëpërmjet së cilës kërkon heqjen dorë nga ankimi i paraqitur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit më datë 13.04.2018, për subjektin e rivlerësimit Sulejman Tola.

2.2 Komisioneri parashtron se në ankimin e tij janë ngritur shkaqe që lidhen me zbatimin e gabuar të legjislacionit gjatë administrimit, duke kërkuar rregullimin e pasojave të dorëheqjes së magjistratit për efekt të parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

2.3 Zbatimi dhe ndalimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës paraqet interes publik, ndaj në rastet e paraqitjes së dorëheqjeve nga subjektet, për të shmangur rivlerësimin, sanksionohet ndalimi i emërimit gjyqtar, prokuror, anëtar i KLGJ-së, KLP-së, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.

2.4 Shkaqe të tjera ankimore lidhen me detyrimin e përcaktimit të pozitës juridike të magjistratit dhe verifikimin e rrethanave procedurale që e ndikojnë në rrugë ligjore ecurinë e procesit të rivlerësimit si pasojë e dorëheqjes së subjektit, duke diktuar më tej vendimmarrjen për pushimin e procesit të rivlerësimit.

2.5 Komisionerët Publikë, nëpërmjet shkresës nr. 4030/1 prot., datë 01.06.2018, së Institutit të Sigurimeve Shoqërore (depozituar në KPA, kopje e njësuar me origjinalin, bashkëngjitur shkresës së heqjes dorë nga ankimi), janë vënë në dijeni se subjektit të rivlerësimit Sulejman Tola, i është caktuar pension pleqërie me vendimin nr. 930, datë 10.05.2017, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës.

2.6 Nga përmbajtja e shkresës rezulton se z. Sulejman Tola ka mbushur moshën për përfitimin e pensionit të pleqërisë, duke u bazuar në ligjin nr. 7730, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë kuptim, është e pamundur që ai të emërohet në një nga pozicionet e parashikuara nga paragrafi i dytë i nenit G të Aneksit të Kushtetutës, i cili ishte një ndër shkaqet kryesore të ankimit të Komisionerit Publik.

2.7 Shkaqet juridike procedurale të cilat janë bërë pjesë e ankimit kundër vendimit nr. 4, datë 23.03.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, janë të njëjta dhe do të mund të gjejnë përgjigje nga vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për ankimet e ngjashme që do të gjykohen në vazhdim nga ky Kolegj.

2.8 Duke u nisur nga shkaqet dhe arsyetimi i mësipërm, duke vlerësuar elemente të rëndësishme gjatë kryerjes së rivlerësimit, si eficienta dhe shpejtësia e gjykimit, si dhe parimin e ekonomisë gjyqësore, Komisionerët Publikë kanë kërkuar heqjen dorë nga ankimi nr. 9/1 prot., datë 13.04.2018, ndaj vendimit nr. 4, datë 23.03.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Sulejman Tola, pasi në kushtet aktuale të disponimit të pensionit të pleqërisë, nuk ekziston më rreziku që subjekti të vijojë ende të gëzojë lirisht statusin e magjistratit.

2.9 Referuar nenit C, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, Komisionerët Publikë përfaqësojnë interesin publik dhe mund të paraqesin ankim kundër vendimit të Komisionit. Në rastin objekt shqyrtimi, nuk ka interes publik për arsye se është provuar që subjekti Sulejman Tola gëzon pension pleqërie, ndaj është e pamundur që ky subjekt të rikthehet në një nga pozicionet e parashikuara nga pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

2.10 Qëllimi i ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” është garantimi i funksionimit të sistemit gjyqësor, funksionimi i shtetit dhe i së drejtës, si dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi. Ky ligj u njehtë drejtën subjekteve për t’u dorëhequr në bazë të nenit 56, i cili përmban kushte specifike kohore dhe përfitime sipas pikës 2 të tij, si dhe në bazë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon ndalim në pikën 2.

2.11 Nga kjo e drejtë ka përfituar subjekti Tola, i cili ka kërkuar dorëheqjen nga funksioni i prokurorit. Siç del nga shkresa e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me nr. 4030/1 prot., datë 01.06.2018, e sjellë nga Komisioneri Publik, dorëheqja është deklaruar nga subjekti në prag të pensionit. Menjëherë pasi është vënë në dijeni Komisioneri Publik për faktin, ka kërkuar informacion në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, ku ky i fundit e ka njoftuar me shkresën e sipërcituar, që tashmë subjekti është pensionist.

2.12 Nga analiza e shqyrtimit të çështjes, rezulton se interesi publik, që mbrohet nga Komisioneri Publik, e ka humbur qëllimin në rastin objekt shqyrtimi, ndaj heqja dorë nga ankimi vlerësohet e drejtë.

III

Arsyetimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Dispozitat ligjore të zbatueshme në çështjen në diskutim dhe arsyetimi i Kolegjit

3.1 Trupi Gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit vendosi të zhvillojë seancë në dhomë këshillimi, sipas parashikimeve të dispozitës së nenit 65, pika 1¹ e ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.” Këto dispozita parashikojnë që gjykimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit të bëhet sipas disa dispozitave specifike të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative,” e saktësisht nenit 49, pika 1² e këtij të fundit. Pra, meqenëse Kolegji u gjend përpara tërheqjes së ankesës nga Komisionerët Publikë për subjektin

¹ Neni 65, pika 1 e ligjit 84/2016 parashikon: “1. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

² Neni 49, pika 1 e ligjit 49/2012 parashikon: “1. Shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit”.

e rivlerësimit në fjalë, dispozitat e nenit 65, pika 3³ që diktojnë seancë publike nuk zbatohen. Si rrjedhojë, në vlerësimin e Kolegjit, çështja duhej të shqyrtohej në dhomë këshillimi.

3.2 Kushtetuta në nenin 179/b, pika 5 e saj parashikon: “Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese [...]”, dhe sipas kësaj dispozite kushtetuese është Komisioneri Publik që vë në lëvizje Kolegjin e Posaçëm të Apelit, përveç subjekteve të rivlerësimit, për shqyrtimin e ankimeve eventuale ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

3.3 Neni 179/b, pika 10 e Kushtetutës, parashikon: “Procedurat dhe kriteret e rivlerësimit rregullohen sipas parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit 84/2016”.

3.4 Neni C, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, parashikon: “Dy komisionerë publikë përfaqësojnë interesin publik dhe mund të paraqesin ankim kundër vendimit të Komisionit”.

3.5 Në nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, parashikohet: “Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra sipas nenit E, paragrafi 2, të Aneksit”.

3.6 Në referencë të këtyre dispozitave kushtetuese, sidomos parashikimeve në nenin 179/b, pika 10 e Kushtetutës, procedurat e rivlerësimit në lidhje me institutin e heqjes dorë nga ankimi të Komisionerit Publik, do të rregullohen sipas parashikimeve të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3.7 Konkretisht, në nenin 4 pika 6 e ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet: “Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji”.

3.8 Meqenëse, si Kushtetuta, edhe ligji 84/2016 nuk i rregullojnë drejtpërdrejt procedurat në lidhje me institutin e heqjes dorë nga ankimi, atëherë në referencë të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, saktësisht në nenin 1, pika 2 parashikohet: “Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe”. Ndërkohë në nenin 44 të tij parashikohet: “Mjetet dhe afatet e ankimit të vendimeve të gjykatave administrative janë të njëjta me ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj”. Rrjedhimisht, duhet t’i referohemi nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin parashikohet dhe rregullohet heqja dorë nga ankimi sipas këtij përcaktimi: “Në çdo fazë të gjykimit të çështjes në apel, ankuesi ose përfaqësuesi i tij mund të heqë dorë nga ankimi. Në këtë rast vendoset pushimi i shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit”.

3.9 Sa më sipër, Kolegji i Posaçëm i Apelit e konstaton heqjen dorë nga ankimi të Komisionerit Publik dhe, për pasojë, shqyrtimi i kësaj çështjeje duhet të pushohet.

³ Neni 65, pika 3 e ligjit 84/2016 parashikon: “3. Në rastin e ankimit nga Komisioneri Publik, Kolegji i Apelit e gjykon çështjen në seancë publike”.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, nenin 4 pika 6 e ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 1, pika 2 dhe nenin 44 të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe nenin 463 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji i Posaçëm i Apelit

VENDOSI:

Pushimin e shqyrtimit të çështjes me nr. 3/2018 (JR), datë 17.04.2018, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, sa i përket ankimit me nr. 9/1, datë 13.04.2018 të Komisionerit Publik, ndaj vendimit nr. 4, datë 23.03.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Sulejman Tola.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 10.07.2018.

GJYQTAR

Luan DACI

nënshkrimi

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi – kundër

**GJYQTAR
RELATOR I ÇËSHTJES**

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

**GJYQTARE
KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Në cilësinë e anëtarit të Trupit Gjykses, të mbetur në pakicë, parashtroj mendimin tim si më poshtë:

2. Pakica vlerëson se vendimi i shumicës për pushimin e shqyrtimit nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim "Kolegji") të çështjes nr. 3/2018 (JR), datë 17.04.2018, lidhur me ankimin e ushtruar nga Komisioneri Publik nr. 9/1, datë 13.04.2018, ndaj vendimit nr. 4, datë 23.03.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është marrë në kuadër të një procesi gjyqësor të zhvilluar në shkelle të rëndë të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim referuar ligji 84/2016) dhe të rregullave procedurale të zbatueshme, me rëndësi themelore për zhvillimin e praktikës gjyqësore të Kolegjit dhe për garantimin e të drejtës së palëve për proces të rregullt. Këto shkelle lidhen me formën e zhvillimit të gjykimit dhe me njoftimin e rregullt të seancës gjyqësore.

3. Bazuar në nenin 14, pika 4, shkronja "a" e ligjit 84/2016, kryesuesi i Trupit Gjykses thirrri seancën gjyqësore për shqyrtimin e kësaj çështjeje në dhomë këshillimi, në datën 10.07.2018, ora 11:00.

4. Pakica çmon se për gjykimin e kësaj çështjeje ishte e detyrueshme thirrja e seancës gjyqësore publike, në zbatim të nenit 65, pika 3 e ligjit 84/2016, sipas të cilit: *Në rastin e ankimit nga Komisioneri Publik, Kolegji i Apelimit e gjykon çështjen në seancë publike*. Për rrjedhojë, nuk është në diskrecionin e kryesuesit të trupit gjykses të zgjedhë formën e gjykimit, pasi në rastin e ankimit nga Komisioneri Publik forma e gjykimit në seancë publike është e përcaktuar shprehimisht nga ligji i sipërcituar.

5. Menjëherë pas hapjes së shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, anëtarët Ina Rama dhe Sokol Çomo i kërkuar Trupit Gjykses korrigjimin e gabimit procedural në lidhje me thirrjen e seancës së gjykimit në dhomë këshillimi, duke propozuar marrjen e vendimit për vazhdimin e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit 84/2016.

6. Gjithashtu, pakica analizoi pamundësinë e zhvillimit të gjykimit në dhomë këshillimi edhe për shkak të mosplotësimit të kushteve procedurale që lidhen me njoftimin e rregullt të seancës në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e pikës 2 të nenit 49¹ të ligjit 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar. Sipas këtij neni, sekretaria e Kolegjit njofton palët rregullisht sipas rregullave procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë për përbërjen e trupit gjykses, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes, të paktën 15 ditë përpara. Në zbatim të nenit të sipërcituar dhe nenit 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, njoftimi për përbërjen e trupit gjykses, ditën, orën dhe vendin e gjykimit duhet të bëheshin me shpallje në ambientet e Kolegjit, në faqen e tij të internetit, si dhe me njoftim individual nëse subjekti do të kishte lënë të dhënat e tij elektronike të kontaktit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Në rastin konkret, nga aktet procedurale të fashikullit të gjykimit, rezultojnë

¹ Neni 49, pika 2 parashikon shprehimisht: *Kryetari i trupit gjykses përgatit relacionin dhe cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton palët rregullisht sipas rregullave procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë për përbërjen e trupit gjykses, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes të paktën 15 ditë përpara. Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim.*

se në këndin e njoftimeve në ambientet e Kolegjit dhe në faqen e tij të internetit nuk është bërë shpallja e aktit procedural për thirrjen e seancës. Gjithashtu, në aktin e njoftimit që u është dërguar palëve, nuk është deklaruar përbërja e Trupit Gjykes duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën e subjektit për të vlerësuar nëse çështja e tij do të gjykohej nga një gjykatë e paanshme.

7. Kërkesa e dy anëtarëve të Trupit Gjykes për moszhvillimin e gjykimit në dhomë këshillimi dhe kalimin e gjykimit të çështjes në seancë publike nuk u pranua me vendim të ndërmjetëm nga shumica e Trupit Gjykes, me arsyetimin se Komisioneri Publik ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi i ankimit.

8. Pakica nuk është dakord me këtë vendim të ndërmjetëm të shumicës, për arsye se fakti që Komisioneri Publik nëpërmjet shkresës nr. 9/4 prot., datë 12.06.2018, ka hequr dorë nga ankimi nr. 9/1prot., datë 13.04.2018, i ushtruar ndaj vendimit nr. 4, datë 23.03.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nuk ndikon në formën e shqyrtimit të ankimit, e cila, edhe për shkak të interesit publik, është parashikuar shprehimisht si seancë publike në nenin 65, pika 3 e ligjit 84/2016. Çdo kërkesë procedurale e Komisionerit Publik, e paraqitur përpara fillimit të gjykimit të ankimit në Kolegj, mund të merret në shqyrtim dhe të disponohet lidhur me të nga trupi gjykes vetëm pasi të çelet shqyrtimi gjyqësor në seancë publike. Në çështjen në gjykim, kryesuesi i Trupit Gjykes dhe anëtarët e shumicës kanë bërë vlerësim individual të kërkesës së Komisionerit Publik për heqje dorë nga ankimi lidhur me bazueshmërinë dhe pranueshmërinë e saj para fillimit të shqyrtimit të ankimit nga i gjithë Trupi Gjykes në seancë gjyqësore. Ky gabim procedural nuk justifikon moszbatimin e urdhërimit të nenit 65, pika 3 e ligjit 84/2016. Shqyrtimi dhe vlerësimi i bazueshmërisë dhe pranueshmërisë së kërkesës për heqje dorë të Komisionerit Publik nga ankimet e tij (në mënyrë të veçantë në rastet kur ankimi është bërë mbi bazën e rekomandimit me shkrim të vëzhguesve ndërkombëtarë në përputhje me nenin B, pika 3, shkronja “c” e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65, pika 2 e ligjit 84/2016) duhet të kryhet në seancë publike dhe jo në seancë të mbyllur për palët dhe publikun (dhomë këshillimi), pasi vetëm në seancë publike trupi gjykes, nëpërmjet pyetjeve të drejtpërdrejta që mund t’i bëjë Komisionerit Publik, ka mundësi të verifikojë dhe të sigurohet se vullneti i Komisionerit Publik për heqjen dorë nga ankimi është real dhe i pavesuar. Gjithashtu, nëpërmjet seancës publike, garantohet edhe transparenca për publikun lidhur me shkaqet e mungesës së interesit publik në rastet e kërkesave për heqje dorë nga ankimi të Komisionerit Publik.

9. Në konkluzion të analizës së mësipërme për shkeljet e ligjit lidhur me mënyrën e gjykimit të kësaj çështjeje, vlerësoj se shumica ishte e ndaluar në mënyrë të shprehur nga ligji të shqyrtonte ankimin e Komisionerit Publik dhe të vendoste lidhur me të në dhomë këshillimi. Për këtë arsye, votoj kundër.

Tiranë, më 10.07.2018

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi